

Nr. Prot. _____

Burrel, më ___ / ___ / 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “LA - OR” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71420003R**, me adresë:
Tiranë, Berzhitë, Autostrada Tiranë – Elbasan, Km.6, “PALMA NOVA”.

Procedura e prokurimit: **“E Hapur – Punë”**, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-83171-12-24-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion linjash TM/TU dhe ndërtim kabinash të reja në Njësinë Laç, Agjensia Mirditë, Burrel dhe Bulqizë”**, me fond limit: **54,763,688** (pesëdhjetë e katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi të punimeve: **60** (gjashtëdhjetë) **ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 131, datë 31 Dhjetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: **“LA - OR” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **K71420003R**
Vlera: **53 842 418.91** (pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**
2. Operatori Ekonomik: **“EMC Group” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **L71819032P**
Vlera: **54 653 500.94** (pesëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind pike nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**
3. Operatori Ekonomik: **“ALPHA SOLUTIONS GROUP” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i:
L63620402U
Vlera: **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: **“EMC Group” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **L71819032P**
2. Operatori Ekonomik: **“ALPHA SOLUTIONS GROUP” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i:
L63620402U

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “EMC Group” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “e”, “f” dhe “g”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

g. Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se: nuk ka paraqitur formularin sipas Shtojcës 9, dhe Deklaratat sipas Shtojcës 10 dhe Shtojcës 11.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertët kontabël të licencuar, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (2017, 2018, 2019).

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur bilancet e 3 (tre) viteve të mëparshëm.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.3/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.***

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë që ka operatori ekonomik që**

është i regjistruar në Shqipëri, si dhe vërtetimi i Debisë nuk është jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4 dhe 2.2.5/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.4 Vërtetim bankar për gjëndjen financiare nga një ose më shumë banka në vlerën 10 % të fondit limit që prokurohet, lëshuar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave.

2.2.5 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur Vërtetimin bankar për gjëndjen financiare, si dhe Vërtetimin lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikave 2.3.1 deri në 2.3.8/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- Kushtet e kërkuara në pikat 2.3.1 deri në 2.3.8 për kapacitetin Teknik nuk përmbushen nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e tyre.

- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejtë se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: “ALPHA SOLUTIONS GROUP” sh.p.k, nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (sipas Shtojcë 1 të DST-së) në zbatim të nenit 17 të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe dokumentat e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit,

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “LA-OR” Sh.p.k., me adresë: Tiranë, Berzhitë, Autostrada Tiranë – Elbasan, Km.6, “PALMA NOVA”, me numër Nipt-i: K71420003R, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: 53 842 418.91 (pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë Rajonale e OSSH, Burrel (Dega e Shërbimeve Mbështetëse), me adresë: Rruga “Ibrahim Temo”, lagja “Partizani”, Burrel,

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **26.02.2021**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor